



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 62

Gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1577, datë 26.11.2008	Për rimbursimin e shpenzimeve të transportit për në Shqipëri të trupit të të ndjerit Perikli Teta..... 3
Vendim i KM nr.1578, datë 3.12.2008	Për miratimin e vlerës së të drejtave, që lidhen me aksionet e shtetit në INSIG, sh.a., me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e tyre..... 3
Vendim i KM nr.1583, datë 3.12.2008	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Ballagat, z.Fatos Sharka 4
Vendim i KM nr.1598, datë 2.7.2008	Për lirimimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit..... 4
Vendim i KM nr.1621, datë 3.12.2008	Për dhënie ndihme financiare familjeve të dëmtuara nga shembja e pallatit 5-katësh, në bashkinë e Gjirokastrës 5
Vendim i KM nr.1647, datë 24.12.2008	Për shpërndarjen e fondeve të miratuara për Ministrinë e Shëndetësisë me vendimin nr.1034, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi, në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kryerjen e transplantit të veshkës, për disa shtetas, në Ankara, Turqi”, të ndryshuar, dhe për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të fëmijës Regina Murati..... 6
Vendim i KM nr.1665, datë 17.12.2008	Për shuarjen, me kompensim, të detyrimeve debitore dhe kreditore, që institucionet, shoqëritë tregtare shtetërore dhe “ARMO” sh.a.-ja, kanë ndaj njëri-tjetrit..... 6
Vendim i KM nr.1667, datë 24.12.2008	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Greqi, të z. Mevlan Shanaj..... 7

Vendim i KM nr.1678, datë 24.12.2008	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW-së, Frankfurt am Main, për financimin e programit “Rezervati biosferik ndërkufitar i Prespës-Mbështetja e Parkut Kombëtar të Prespës” 8
Vendim i KM nr.1685, datë 24.12.2008	Për një shtesë në vendimin nr.906, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për shërbimin kombëtar të punësimit” 9
Vendim i KM nr.1703, datë 24.12.2008	Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe të veprimtarive sezonale/të përkohshme, për ministritë dhe institucionet buxhetore..... 11
Vendim i KM nr.1714, datë 29.12.2008	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë” 12

VENDIM
Nr.1577, datë 26.11.2008

PËR RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR NË SHQIPËRI TË TRUPIT TË
TË NDJERIT PERIKLI TETA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Përballimin nga shteti të shpenzimeve të transportit, për kthimin në Shqipëri të trupit të ndjerit Perikli Teta, ish-Ministër i Mbrojtjes dhe oficer i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili ndërroi jetë, më 7 janar 2007, në Spitalin Ushtarak të Aviacionit, në Athinë, Greqi dërguar për trajtim dhe kurim mjekësor nga shteti.

2.Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi, prej 4354 (katër mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) euro, i barasvlefshëm në lekë sipas kursit ditor të shkëmbimit, për ambasadën shqiptare, në Athinë, Greqi, për kryerjen e pagesës së shoqërisë së huaj të transportit.

3.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4.Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1578, datë 3.12.2008

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË TË DREJTAVE, QË LIDHEN ME AKSIONET E SHTETIT NË
INSIG, SHA, ME TË CILËN DO TË FILLOJNË NEGOCIATAT PËR SHITJEN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9649, datë 27.11.2006 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sh.a.-së”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e vlerës së aksioneve të shtetit në INSIG, sh.a., sipas raportit të hartuar nga vlerësuesi ndërkombëtar KPMG.

2.Vlera mesatare, e përcaktuar nga vlerësuesi ndërkombëtar, me të cilën do të fillojnë negociatat për shitjen e të drejtave të shtetit në aksionet e INSIG, sh.a.-së të jetë vlera më e ulët.

3.Nëse blerësit e mundshëm ofrojnë çmime blerjeje nën vlerën mesatare, sipas pikës 2 të këtij vendimi, të negociohet me ofertuesit, për rritjen e çmimit të ofruar. Kriteri i vetëm për përzgjedhjen e blerësit do të jetë çmimi më i lartë i ofruar, i cili nuk mund të jetë më i ulët se vlera mesatare, e përcaktuar në raportin e vlerësuesit ndërkombëtar.

4.Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1583, datë 3.12.2008

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS BALLAGAT, Z.FATOS SHARKA

Në mbështetje të neneve 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për kryerjen e një vepre penale dhe dënimin me vendim të formës së prerë nga gjykata të kryetarit të komunës Ballagat, z.Fatos Sharka.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1598, datë 2.7.2008

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Lirimin nga detyra të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, pas përfundimit të mandatit:

-Z.Ofea Dhuci, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë;

-Z.Leandro Haxhi, propozuar nga Ministri i Financave;

Z.Jorgji Bollano, propozuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;

-Zj.Flutura Kalemi, propozuar nga Universiteti Bujqësor, Tiranë.

2.Emërimin në detyrë të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit:

-Z.Jorgji Bollano, propozuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (i rimandaturar);

-Zj.Flutura Kalemi, propozuar nga Universiteti Bujqësor, Tiranë (e rimandaturar);

-Z.Skënder Uku, propozuar nga Ministri i Financave;

-Z.Selman Lamaj, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1621, datë 3.12.2008

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA SHEMBJA E
PALLATIT 5-KATËSH, NË BASHKINË E GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare familjeve, të cilave iu dëmtuan banesat nga shembja e pallatit, në lagjen “11 janari”, në bashkinë e Gjirokastrës, në vlerën 46 247 160 (dyzet e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe të bëhet efektiv, nëpërmjet këshillit të qarkut të Gjirokastrës.
3. Vlera e kompensimit financiar për anën ndërtimore, për dëmtimin e pajisjeve të çdo familjeje, si dhe për familjarët, që kanë banuar me qira, do të jetë sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe këshilli i qarkut të Gjirokastrës për zbatimin e këtij vendimi
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TABELA E VLERËSIMEVE PËR EFEKT TË DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE
FAMILJARËVE TË CILËVE U JANË DËMTUAR BANESAT NGA SHEMBJA E PALLATIT NË
GJIROKASTËR**

Nr	Emri i pronarit	Emërtimi i objektit	Sip.	Çmimi	Vlera	Vlera e pajisjeve e orendive	Vlera totale
			banimit ne m-2	për njësi			
1	Ibrahim Braho	apartament banimi	116.1	28,024	3,253,587	400,000	3,653,587
2	Krenar Nikicaj	apartament banimi	116.1	28,024	3,253,587	400,000	3,653,587
3	Thanas Zoko	apartament banimi	116.1	28,024	3,253,587	400,000	3,653,587
4	Vasil Pulla	apartament banimi	116.1	28,024	3,253,587	400,000	3,653,587
5	Shpëtim Llocko	apartament banimi	116.1	28,024	3,253,587	500,000	3,753,587
6	Vasil Vangjelidhi	apartament banimi	85.2	28,024	2,387,645	500,000	2,887,645
7	Trashëgim Roshi	apartament banimi	85.2	28,024	2,387,645	500,000	2,887,645
8	Axhem Mene	apartament banimi	85.2	28,024	2,387,645	500,000	2,887,645
9	Vullnet Sinani	apartament banimi	85.2	28,024	2,387,645	500,000	2,887,645
10	Izmo Haska	apartament banimi	88.7	28,024	2,485,729	500,000	2,985,729
11	Hader Haska	apartament banimi	88.7	28,024	2,485,729	500,000	2,985,729
12	Jetnor Dajlani	apartament banimi	88.7	28,024	2,485,729	500,000	2,985,729
13	Bilbil Tena	apartament banimi	88.7	28,024	2,485,729	400,000	2,885,729
14	Sokrat Papadhropuli	apartament banimi	88.7	28,024	2,485,729	400,000	2,885,729
15	Shkëlqim Hunda	qiraxhi				400,000	400,000
16	Basnik Abazi	qiraxhi				400,000	400,000
17	Fejzi Aliu	qiraxhi				400,000	400,000
18	Migjen Nushaj	qiraxhi				400,000	400,000
		Vlera totale			38 247 160	8 000 000	46 247 160

VENDIM
Nr.1647, datë 24.12.2008

**PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË ME
VENDIMIN NR.1034, DATË 9.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË
FONDI, NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR
MBULIMIN E SHPENZIMEVE, PËR KRYERJEN E TRANSPLANTIT TË VESHKËS, PËR DISA
SHTETAS, NË ANKARA, TURQI”, TË NDRYSHUAR, DHE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
TË KURIMIT TË FËMIJËS REGINA MURATI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve, të miratuara për Ministrinë e Shëndetësisë, me vendimin nr.1034, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave, “ Për një shtesë fondi, në Buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve, për kryerjen e transplantit të veshkës, për disa shtetas, në Ankara, Turqi”, të ndryshuar, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të fëmijës Regina Murati.
 2. Efektet financiare në këtë rast, të përballohen nga fondet e papërdorura, dhënë Ministrisë së Shëndetësisë, me vendimin nr.1034, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni i kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1665, datë 17.12.2008

**PËR SHUARJEN, ME KOMPENSIM, TË DETYRIMEVE, DEBITORE DHE KREDITORE, QË
INSTITUCIONET, SHOQËRITË TREGTARE SHTETËRORE DHE “ARMO” SHA-JA, KANË
NDAJ NJËRI-TJETRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.9993, datë 18.9.2008 “Për ratifikimin e kontratës së shitjes së 85 për qind të aksioneve të ARMO, sh.a.-së, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe blerësit “Amra Oil” sh.a., dhe konsorciumit “Refinery Associates of Texas, Anika Enterprises&Mercuria Energy Group” me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Shuarjen, me kompensim, të detyrimeve, debitore dhe kreditore, që institucionet, shoqëritë tregtare shtetërore dhe “Armo” sh.a.-ja, kanë ndaj njëri-tjetrit deri në vlerën, që këto detyrime pasqyrohen në bilancin e vitit 2007, të “Armo” sh.a.-së.
- 2.Mbylljen e llogarive për detyrimet debitore, të provizionuara në vite.

3.Shuma e detyrimeve, debitore dhe kreditore, që institucionet shtetërore dhe “Armo”, sh.a.-ja, kanë ndaj njëri-tjetrit, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi, të sistemohen me llogarinë “Fondet e veta” për institucionet shtetërore, dhe me llogarinë “Fitime dhe humbje”, për “Armo”, sh.a.-në.

4.Shuma e detyrimeve debitore dhe kreditore, që shoqëritë, ndërmarrjet shtetërore dhe “Armo”, sh.a.-ja, kanë ndaj njëri-tjetrit të sistemohen, përkatësisht, me llogarinë “Fitime dhe humbje”, “Albpetrol”, sh.a.-ja t’i sistemojë këto detyrime, duke ndryshuar kapitalin themeltar.

5.Pas sistemimeve të mësipërme rezultati i “Armo”, sh.a.-së nuk ndryshon.

6.Totali i detyrimeve debitore, të mbetura pas sistemimit të mësipërm, të kompensohet me totalin e detyrimeve kreditore. Diferenca kreditore të pasqyrohet në bilancin e “Armo” sh.a.-së, si detyrim ndaj “Albpetrol”, sh.a.-së.

7.Tabelat, që i bashkëlidhen vendimit, janë pjesë përbërëse e tij.

8.Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1667, datë 24.12.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT, NË GREQI, TË Z. MEVLAN SHANAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 1 875 000 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për përballimin e shpenzimeve të kurimit, në Greqi, të z. Mevlan Shanaj.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1678, datë 24.12.2008

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, DHE KFW-SË, FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT
“REZERVATI BIOSFERIK NDËRKUFITAR I PRESPËS-MBËSHTETJA E PARKUT KOMBËTAR
TË PRESPËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW-së, Frankfurt am Main, për financimin e programit “Rezervati biosferik ndërkufitar i Prespës-Mbështetja e Parkut Kombëtar të Prespës”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1685, datë 24.12.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.906, DATË 19.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, PËR SHËRBIMIN
KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001“Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.906, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet prona “Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik, Gjirokastrë”, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror Ministria e Punë, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Shërbimi Kombëtar i Punësimit										
Bashkia Gjirokastrë Fusha e përdorimit të pronës: Drejtori Rajonale e Formimit profesional Publik, Gjirokastrë										
Nr rend.	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr.pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip.totale e pronës m ²	Nga sip.totale sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti përgjegjës administrativ	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			Administrative	Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik (ish Turizmi i ri Gjirokastrë)	8000	425	Drejtori Rajonale e Formimit Profesional Publik	MPÇSSHB	SHKP/DRFPP Gjirokastrë	Ambientet ndodhen në ndërtesën e ish-Turizmit të ri, Gjirokastrë dhe kanë kaluar në pronësi të MPÇSSHB me urdhër të përbashkët të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me nr.1, datë 26.12.2006, dhe urdhrit nr.100, dt.13.12.2007 të Ministrisë Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

VENDIM
Nr.1703, datë 24.12.2008

PËR VENDOSJEN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE DHE TË VEPRIMTARIVE
SEZONALE/TË PËRKOZHME, PËR MINISTRITË DHE INSTITUCIONET BUXHETORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Veprimtaritë sezonale/të përkohshme, që kryejnë ministrinë dhe institucionet buxhetore gjatë veprimtarisë së tyre vjetore, vlerësohen si shërbime dhe realizohen me sipërmarrje, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për prokurimin e tij si shërbimet e tjera normale.

2.Kur veprimtaritë sezonale/të përkohshme nuk mund të realizohen me sipërmarrje apo nga punonjësit e miratuar në organikën e ministrisë/institucionit buxhetor, mund të realizohen, nëpërmjet marrjes në punë të punonjësve, me kontratë të përkohshme.

Ministrinë/institucionet propozojnë marrjen e punonjësve shtesë, me kontratë të përkohshme, jashtë numrit të punonjësve buxhetorë të miratuar. Kërkesa i dërgohet Ministrisë të Financave, i cili pasi e shqyrton, e dërgon në Këshillin e Ministrave. Miratimi i punonjësve me kontratë të përkohshme, bëhet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

3.Për efekt të këtij vendimi, punonjës me kontratë të përkohshme pune vlerësohen ata punonjës, të cilët kryejnë një veprimtari:

-sezonale;

-të domosdoshme, por që realizohet në një periudhë kohore të shkurtër, jo më shumë se 6 muaj;

-të reduktuar, me kohë të pjesshme ditore pune, që mund të shtrihet gjatë të gjithë vitit buxhetor;

- dytësore, të institucionit, dhe që paguhet nga të ardhurat e kësaj veprimtarie.

4.Për efekt të këtij vendimi, nuk vlerësohen punonjës me kontratë të përkohshme pune mësuesit në dispozicion, në sektorin e arsimit, dhe instruktorët, me kohë të pjesshme, në shkollat e formimit profesional.

5.Për efekt të këtij vendimi, nuk do të vlerësohen dhe trajtohen si punonjës me kontratë ekspertët e fushave të ndryshme, të licencuar. Shërbimi i ofruar prej tyre u nënshtrohet procedurave përkatëse të prokurimit publik apo akteve të veçanta ligjore, në fuqi.

6.Punonjësi me kontratë të përkohshme paguhet në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pozicionin, për të cilin ai kontraktohet dhe merret në punë, në përputhje me kriteret e parashikuara për atë vend pune.

7.Çdo propozim i ministrive/institucioneve qendrore për punonjës me kontratë të përkohshme shoqërohet me të dhëna të hollësishme për numrin, profesionin, afatin kohor të kontraktimit (muaj ose ditë ose orë/ditë) dhe pagesën përkatëse.

8.Ministria e Financave, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme dhe detajimit të tyre nga institucionet përkatëse, e depoziton dokumentacionin përkatës në degët e thesarit. Degët e thesarit lejojnë kryerjen e pagesës për punonjësit me kontratë të përkohshme dhe sipas periudhës kohore të përcaktuara në kontratë.

9.Fondet e nevojshme financiare për veprimtarinë sezonale ose të përkohshme të përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë apo institucionin, buxhetor, si më poshtë vijon:

-Për veprimtarinë sezonale ose të përkohshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes;

-Për veprimtarinë sezonale ose të përkohshme, sipas pikës 2 të këtij vendimi, nga shpenzimet për personelin (nga fondet e kushtëzuara ose të pakushtëzuara të miratuara në ligjin përkatës të buxhetit).

10.Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1714, datë 29.12.2008

PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.600, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SË LARTË SHTETËRORE DHE TË FUNKSIONARËVE POLITIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20, të ligjit nr.8550 datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, të nenit 30 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 12, të ligjit nr.8095, datë 21.3.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin nr.600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “ë” të pikës 1, shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) gjykatësit e gjykatave të apelit dhe të gjykatave të rretheve gjyqësore.”.

b)Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4.Listat për marrjen e kredive miratohen nga titullarët e ministrive e të institucioneve përkatëse, brenda numrit të miratuar nga Kryeministri, dhe më pas dërgohen në bankën e përzgjedhur, e cila është e detyruar të respektojë renditjen e përcaktuar në këto lista.”.

c)Në pikën 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Fjalja e fundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kryeministri, në përputhje me kërkesat e paraqitura nga ministrinë e institucionet përkatëse, miraton numrin e përfituesve të kredive, për çdo institucion.”.

ii)Në fund të kësaj pike shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kërkesat paraqiten vetëm pasi ministrinë e institucionet përkatëse të kenë shqyrtuar dhe verifikuar plotësimin e kriterëve, të parashikuara në pikën 6 të këtij vendimi, dhe të shoqërohen me dokumentacionin përkatës, të paraqitur nga subjektet, që përfitojnë të drejtën për strehim a sipërfaqe shtesë banimi.”.

2.Ngarkohen ministrat dhe drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 2.8.2010

Doli nga shtypi më 4.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 14 lekë